

## **Fjala e Znj. Irena Beqiraj**

Të nderuar pjesëmarrës, e nderuar drejtore, të nderuar kolegë!

Sinqerisht ndihem shumë mirë që jam mes jush, sepse unë deri para një viti kam qenë një prej jush, pasi kam qenë anëtare e bordit të drejtimit të fondit të shoqërisë SiCRED sh.a. dhe kam qenë në brendësi të të gjithë ecurisë së fondeve vullnetare të pensioneve në Shqipëri. Kuptohet që ky është një ndryshim i madh, i cili ka ndodhur këto dy vitet e fundit dhe për këtë duhet të përshëndesim jo vetëm anëtarët për guximin, pra shoqëritë administrative, por edhe AMF-në për mbështetjen. Kuptohet, duke qenë një prej jush në pjesën më të madhe të kohës, kam qenë në dijeni dhe në diskutime me kolegët për të gjitha problemet që ka pasur legjislacioni fiskal, i cili shpeshherë binte në kundërshti me lehtësirat fiskale që parashikonte ligji i fondeve të pensioneve vullnetare.

Sot, me shumë krenari mund të themi se që në paketën fiskale të 2014, qeveria e re ka reflektuar dhe ka prurë disa ndryshime shumë të rëndësishme, disa lehtësi fiskale shumë të rëndësishme që mund të them janë çelës për rritjen e fondeve vullnetare të pensioneve. Më lini t'i përmend shkurtimisht dhe pse pjesa më e madhe e juaja i dinë:

- U përjashtuan nga tatimi mbi të ardhurat personale të gjitha kontributet e bëra nga anëtarët e fondeve të pensionit në bazë të ligjit të fondeve të pensioneve.
- U përjashtua nga tatimi kthimi nga investimi, ku përfshihen të gjitha kthimet nga kapitali.
- U përjashtua nga tatimi mbi fitimin fondi i pensionit vullnetar i administruar nga shoqëria administruese.
- U njohën si shpenzime të zbritshme për punëdhënësin të gjitha fondet që ata paguanin për punonjësit e tyre deri në shumën 25,000 lekë.

Madje duhet të përshëndesim Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare për mbështetjen që i dha këtij ndryshimi në legjislacionin fiskal.

Për më tepër, ne jemi duke hartuar një ligj të ri për tatimin mbi të ardhurat, shpeshherë i kontestuar që në draft, por jemi shumë të lumtur që kemi komentet tuaja, të bankave, të fondeve vullnetare dhe të të gjithë pjesëmarrësve. Gjithsesi, ky do të jetë një ligj avantgard që do të afrojë taksimin mbi të ardhurat personale dhe të ardhurat e korporatave me taksimin që gjendet sot në vendet e rajonit dhe në të gjithë Evropën. Ju premtoj se do të ruhen të gjitha lehtësitë që kemi ofruar në paketën e vitit 2014 për ligjin mbi të ardhurat, por ndërkohë jemi të hapur për çdo sugjerim tjetër për ta marrë në konsideratë dhe për ta pasur pjesë të vendimmarrjes.

Një arritje tjetër, jo vetëm për fondet e pensionit, por edhe për shoqëritë e sigurimit, ishte përjashtimi nga TVSH-ja, i cili dikur diskutohej gjatë nga shoqëritë, e sot është i shkruar në ligj.

Në të përcaktohet se të gjitha shërbimet apo transaksionet që kryhen nga fondi vullnetar, sigurimet dhe risigurimet janë të përjashtuara nga TVSH-ja.

Kuptohet, jo të gjithë kolegët ekonomistë ndajmë të njëjtën pikëpamje se zhvillimi vjen gjithmonë nga incentivat fiskale. Incentivat fiskale janë shumë të rëndësishme kur lidhen në momentin që gjendet industria. Ndoshta në hapat e parë, në nisje janë jashtëzakonisht të rëndësishme, dhe aq më tepër në një vend si Shqipëria ku kultura e të menduarit për pensionin është disi e vakët. Ne jemi një komb i ri dhe nuk mendojmë shumë se kur të plakemi e si do ta financojmë pleqërinë tonë. Për këtë arsye, incentivat fiskale në këtë fushë ishin jashtëzakonisht të rëndësishme për të motivuar njerëzit të futen në fondet vullnetare dhe për të menduar më gjatë për pleqërinë e tyre. Kuptohet që janë shumë të rëndësishme për të gjithë ekonominë shqiptare, aq më tepër për sistemin shtetëror të fondeve të pensioneve, sepse duhet të jenë një plotësues shumë i mirë dhe do të zbusin një problem që aktualisht është social, siç është financimi i pensionistëve. Kështu që besoj se është e rëndësishme nga të dy palët dhe nga qeveria, dhe nga ana juaj, të shtojmë më shumë ndërgjegjësimin për pjesëmarrjen në fondet vullnetare të pensioneve; e po ashtu, edhe me dëshirën nga të punësuarit për të deklaruar pagën totale dhe për të paguar sigurimet e detyrueshme të pensioneve. Veçanërisht AMF duhet të shtojë ndërgjegjësimin për këto skema. Do të ishte një mrekulli nëse në një të ardhme të afërt do të prezantonim edhe kolonën e dytë, pjesë e fondit të detyrueshëm e menaxhuar nga shoqëritë administrative private ose ndryshe lidhjen e llogarisë së kursimit të pensionit me emrin, siç e quaj unë. Kjo do të ishte diçka shumë e mirë, dhe do të arrinim të krijojmë një demokraci, e cila nuk shfrytëzon burimet e të ardhmes për të jetuar në të sotmen.

Faleminderit,